ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

ANKESË

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237,

Një ankesë kundër: SPITALI SHEIKH ZAYED,Adresa e AK: RR.BEDRI PEJANI

Qyteti: VUSHTRRI,Personi Kontaktues: Sami Ahmetaj,E-mail: Sami.Ahmetaj@rks-gov.net, Telefoni: 045/780902

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP; 10/220/70050/00000/0731-24-5027-2-2-1

Sa i përket tenderit për; Sigurimi fizik i objektit te Spitalit të Përgjithshëm Vushtrri

1. IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i operatoreve ekonomik " MEB L.L.C & KSF" MAJOR" SH.A
(emri i operatorit ekonomik)

Rr. Edit Durhan nr 213
(Adresa e OE)

Prizren, Kosove
(Selia)

meb.llc1@gmail.com
Adresa elektronike)

Silaaytolun Damka +38348189198
(Drejtori)

26.06.2024
(Nënshkrimi) (Data)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Zyra e prokurimit të SPITALIT SHEIKH ZAYED ne tekstin e mëtejmë do t' i referohemi si Autoriteti Kontraktues me datë 22 maj 2024 ka dorëzuar ne KRPP njoftimin për kontratë me titull te kontratës; Sigurimi fizik i objektit te Spitalit të Përgjithshëm ne Vushtrri.

Tenderi është publikuar ne Ueb faqen të KRPP-së në; 22 maj 2024 në;

- Procedurë të hapur,
- Kontrate publike kornize për 24 muaj.
- Numër të e-prokurimit10/220/70050/00000/0731-24-5027-2-2-1
- Vlera e kontratës; Vlerë e mesme
- Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,
- Vlera e parashikuar e kontratës; 96,000.00 €

Afati i fundit për pranim të tenderëve është caktuar me datë 03.06.2024 në ora 12:00 në platformën e e-prokurimit.

Me date 14.06.2024, AK ka publikuar ne e-platformën e prokurimit Njoftimin për Vendimin e AK-se ku ka shpërblyer me kontratë Kompaninë e Sigurimit fizik "Scorpion" me adresë Rr, Vëllezërit Gërvalla , numër 54 , Ferizaj, Kosovë me vlerë totale të tenderit prej 90,316.80 € .

Me date 19.06.2024 ne cilësi te palës se interesit Grupi i operatoreve ekonomik " MEB LLC& KSF" MAJOR ka ushtruar Kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-se (B58) .

Me datë 20.06.2024 AK ka shqyrtuar Kërkesën për rishqyrtim dhe ka marre Vendimin për refuzimin e kërkesës dhe si rrjedhoje e kësaj ka lënë ne fuqi Njoftimin për Vendimin e AK-se për shpërblim te kontratës.

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Hapja e tenderit është bere përmes platformës elektronike te E-prokurimit ne kohen e caktuar ne Njoftimin për kontratë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

N/A

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I pa kënaqur me Njoftimin mbi rezultatin e tenderit (B58) dhe në pajtim me 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092 , parashtrojmë këtë Kërkesë për Rishqyrtim të;

- **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues (B58)** te datës 14.06.2024, ku AK ka propozuar për shpërblim të kontratës operatorin ekonomik; "Scorpion" me vlerë totale të tenderit prej 90,316.80 €
- **Njoftimit për eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit** (Letrës standarde për tenderues te eliminuar),
- **Vendimit për refuzimin** e kërkesës për rishqyrtim te AK-së të datës 20.06.2024

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. **Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:**

- Nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit dhe
- Neni 60 Kriteret për dhënie të kontratës,
- Nenit 61 , Tenderët Jo-Normalisht te ultë
- Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

II. **Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.**

- Neni 38, Sqarimi i tenderëve
- Neni , 41, Tenderët jo-normalisht të ultë

Në vazhdim të kësaj ankese do t' i argumentojmë pretendimet tona ankimore lidhur me shkeljet e dispozitave të;

1. ***Të dispozitave të LPP-se në RK.***

- **Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues me vendimin e vet që të shpërblej me kontrate tenderin e OE; " "Scorpion" me vlerë totale të tenderit prej 90,316.80 € i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit ne vlere prej 90,316.80 €, ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6, paragrafin 1. dhe paragrafi 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 dhe 2 te këtij ligji,

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar ne Vendimin e AK-se për rezultatin e tenderit i cili ka propozuar për shpërblim te kontratës, tenderin e OE ne vlere prej; 90,316.80 € si dhe bazuar ne tenderin e parashtruesit te kësaj kërkese Grupit te OE;(MEB LLC& KSF"Major" shpk) cili ka ofertuar me çmim prej; 86,169.60 €, shohim qarte se AK, e ka dëmtuar buxhetin e AK-se dhe taksapaguesve te Kosovës ne vlere prej; 4,147.20 € dhe me këtë rast ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 te LPP-se.

- **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar qe tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje te OE te përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit si dhe Kriterin për dhënie te kontratës, si dhe bazuar ne Vendimin e AK-se për shpërblim te kontratës, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

- **Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se ne momentin kur ka marre vendim për eliminimin e Grupit të OE: "MEB LLC"& KSF"Major"SH.A, i cili ka ofruar dëshmi dokumentare mbi plotësimin e te gjitha kërkesave për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender të cilat janë kërkua ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit konkretisht ne paragrafin; 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional te Dosjes se tenderit dhe në paragrafin III-2.4 të Njoftimit për kontrate.

Ne vazhdim te kësaj kërkese po citoj Kërkesat e AK-se te përcaktuara ne paragrafin 9.1&9.2 te FDT-se ;

Kërkesat mbi mundësi të teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** Kërkesa1. Operatori. Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të prezantojë një Deklaratë se do të paguajë pagën bazë për punëtorë 410.00€ Bruto dhe se do të respektojë Aneksin 1 dhe Ligjin e Punës Nr.03 L-212. Po ashtu, deklaratës duhet ti bashkëngjitet Analiza Financiare me të gjitha llogaritjet	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* . Dëshmia 2. Të dëshmohet me një Deklaratë dhe Analizë Financiare të vulosur dhe të nënshkruar. Analiza financiare duhet të përfshije Pagën bazë 410.00€ Bruto, të pasqyruara me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet te përfshijë -Pagat bazë Bruto 410.00 € për punëtorë, - Kontributet pensionale (kontributi i punëtorit 5%, kontributi i punëdhënësit 5% si dhe tatimi mbi paga), -Pagesat shtesë për ndërrimet e natës për 4 punëtoret që punojnë 12 orësh, -Pagesën shtesë për orët gjatë vikendit, -Pagesën shtesë për festat zyrtare, -Pushimet vjetore dhe mjekësore, - Vlera nga dy palë uniforma verore dhe dy palë dimërorë për 5 punëtoret, -Paga, më te gjitha kontributet për pozitën e menaxherit apo përgjegjësit nga

		Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të prezantojë Raportin e Vlerësimit të riskut, të lëshuar nga një institucion apo kompani private e licencuar për Vlerësimin e Riskut. .	kompania për mbikëqyrjen e punëtoreve, e cila pagë nuk mund te jete më e vogël se paga bazë Bruto e punëtoreve; -TVSH-ja 18%, llogaritja në fund për te gjitha pozicionet, si dhe, -Totali i ofertës. Analiza financiare duhet të llogaritet me radhë sipas pozicioneve të kërkuara dhe çdo llogaritje e formës tjetër, e bën OE-në të papërgjegjshëm. 4. Të dëshmohet me raport të vlerësimit të riskut nga një institucion apo kompani private e licencuar për Vlerësimin e Riskut.

Bazuar ne dosjen e tenderit te cilën e ka dorëzuar Parashtruesi i ankeses, pretendojmë se Grupi i OE " MEB LLC& KFS"MAJOR" SH.A . " ka ofruar dëshmitë konforme Kërkesës 9.1&9.2 te FDT-se Dosjes se tenderit dhe Njoftimit për kontrate të AK-se.
Ne vijim do te përpiqemi qe t' i argumentojmë pretendimet tona, dhe atë si në vijim;

Pretendimi i AK-se për eliminim.
AK ne letrën standarde për tenderues te eliminuar nder te tjera ka konstatuar se;

1.Komisioni i vlerësimit ka konstatuar ofertën e juaj të pa përgjegjshme sepse oferta e juaj me çmimin më ultë çmimi real për arsye se ju keni kalkuluar çmimin për orën e punëtorit duke filluar nga çmimi i orës neto 1.04 euro ne vend se te kalkulohet nga çmimi i orës 2.33 euro bruto siç është kërkuar ne DT, gjithë ashtu keni kalkuluar gabim orët dhe vlerat e çmimeve për pozicionet (Orët e festave, orët e vikendeve , vlerën e pushimeve mjekësore) me pak se orët reale që i takojnë çdo punëtori për orët shtese sipas Ligjit Nr.03/L212 të punës. Ne vazhdim të arsyetimit të eliminimit AK ka bere kalkulime ne analizën ofertën financiare si dhe është përpjekur me arsyetuar eliminimin duke u bazuar ne nenin 61 te LPP-se.
2. Komisioni vlerësues gjate shqyrtimit te ofertës ka evidentuar se ju mungon raporti i vlerësimit riskut , te lëshuar nga një institucion apo kompani private e licencuar për vlerësimin e riskut, OE ka prezantuar një

kontrate e cila është e lidhur për kryerjen e shërbimeve për ndonjë aktivitet tjetër si dhe është me afat te skaduar.

Argumenti 1.

Parashtruesi i ankesës ka nënshkruar Deklaratën, ku ka marre përgjegjësinë qe gjate periudhës se ekzekutimit te kontratës do te i paguaj minimumin 410 euro pagën mujore Bruto për një punëtor te sigurimit fizik , i cila ka qen kërkesë formale administrative për kualifikim dhe përzgjedhje te OE e AK-se si dhe ka ofruar Analize te detajuar financiare lidhur me pagesën e pagës Bruto si dhe obligimeve tjera te cilat burojnë nga Ligji i punës dhe Ligji për administrimin e procedurave tatimore.

AK ka zbatuar gabimisht nenin 31 paragrafin 1 dhe 2 ,te LPP-se ne kohen e përgatitjes se dosjes se tenderit dhe Njoftimit për kontratë duke përcaktuar kriteret për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender.

Ne njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit ne paragrafin e mësipërm ka kërkuar nga OE Operatoret Ekonomik duhet të prezantojë një Deklaratë se do të paguajë pagën bazë për punëtorë 410.00€ Bruto dhe se do të respektojë Aneksin 1 te dosjes se tenderit ku nder te tjera është kërkuar qe te respektohet Ligjin e Punës Nr.03 L-212. Po ashtu, deklaratës duhet ti bashkëngjitet Analiza Financiare me të gjitha llogaritjet.

Autoriteti kontraktues në raste te tilla kur kërkohen analiza te tilla financiare duhet vetë autoriteti kontraktues te i saktësoj se cilat elemente (pozicione) te shpenzimeve duhet te përfshihen ne analizën financiare dhe te paraqes forma te tilla ne formën Excel te bazuara ne Ligjin e punës dhe Ligjin mbi procedurat e administratës tatimore dhe atëherë te mbetet vetëm obligim i operatoreve ekonomik plotësimi i tyres me çmime dhe ne këtë mënyrë mund te bëhet krahasuesmëria e shpenzimeve (analizave) ne mes te operatoreve ekonomik ofertues.

Nëse i qasemi përshkrimit te çmimit shohim se AK ka kërkuar;

NR.I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA	Sasia e Orëve për 1 muaj	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	Çmimi TOTAL për 1 muaj me TVSH €	Çmimi TOTAL me TVSH € X 24
1	Sigurimi fizik i objektit te Spitalit të Përgjithshëm Vushtrri	Orë	960			
				TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH PËR 24 MUAJ		

- Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [+/- 30%].

Çmimin për njësi për 1 muaj qe donë te thotë se Autoriteti kontraktues ka kërkuar nga OE qe te ofertojnë për 960 ore për një muaj, ndërkaq ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit ka kërkuar;

Ne vijim te kësaj kërkese po citoj disa pjese te cilat kane te bëjnë me implementimin e kontratës te specifikuara ne aneksin 1 te dosjes se tenderit.

- Operatori ekonomik duhet qe ti angazhoj:

- 5 punëtor me page mujore bazë **410.00 euro Bruto.**

- 2 Ndërrime te punës nga 07:00 - 19:00 dhe 19:00 – 07:00
- Gjatë intervalit 24 orë janë të përfshire 2 punëtorë me nga 12 orë (12+12)
- Gjatë ditës është I përfshirë 1 punëtor me një orar zyrtar prej 8 orë (7:00h ÷ 15:00h),i cili e bënë sigurimin në të njëjtin objekt të Spitalit.

Totali i orëve për 1 muaj është: 960 orë

Kompania obligohet ta respektoj ***Ligjin e Punës*** në fuqi si dhe ***Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004,*** të Republikës së Kosovës.

Operatori Ekonomik duhet të prezantojë një deklaratë se do të paguajë pagën bazë për punëtorë 410.00 € Bruto dhe se do të respektojë Aneksin 1 dhe Ligjin e Punës Nr.03/L-212.

Po ashtu deklaratës duhet ti bashkëngjitet Analiza Financiare me të gjitha kalkulimet e kërkuara.

-Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [+/- 30%].

1 Ofertuesi duhet ta respektoj **Ligjin e Punës nr. 03/L-212** dhe **UA 09/2017 të MPMS** në lidhje me orët e punës për punëtorët.

2 Kompensimin e të ardhurave mujore (paga) në vlerë **jo me te ultë se 410.00 € Bruto** në muaj dhe të paguaj të gjitha kontributet për punëtorët sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212 . ***Sqarim: OE, duhet te dëshmoj me një deklaratë që paga minimale për punëtorët e sigurimit fizik, do të jetë sipas këtij kriteri (410.00€ Burto) dhe kjo deklaratë duhet të jetë në dosjen e OE i cili konkurron në këtë tender..***

3 Kontraktuesi duhet të sigurojë uniformën relevante për punëtorët e sigurimit, pajisjet, mbikëqyrjen, punën dhe lehtësitë e duhura për kryerjen e punëve. ***Sqarim: Uniforma duhet të jetë relevante për çdo punëtorë me qellim që të dallohet stafi nga punonjësit tjerë dhe të siguroj mbarëvajtjen sa më të mirë në punë.***

Vërejtje: Operatori ekonomik është i obliguar që të prezantoj analizën financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar, ku kjo analizë do të përfshijë :

- Pagat bazë Bruto 410.00 € për punëtorë, me te gjitha kontributet si dhe tatimi mbi paga.
- Pagesat shtesë të ndërrimit të natës për 4 punëtor të cilët punojnë 12 orësh, sipas specifikacionit ne dosje te tenderit. Kontraktori është i obliguar që të respektoj ligjin e punës nr. 03/L-212,

- Zëvendësimet e punëtoreve me rastin e pushimeve vjetore dhe pushimeve Mjekësore (sipas ligjit të punës nr.03/L-212)
- Ndërrimi i Vikendeve (kalkulimi sipas ligjit të punës nr.03/L-212),
- Ndërrimi I festive zyrtare sipas kalanderit shtetërorë (kalkulimi sipas ligjit të punës nr.03/L-212),
- Nga dy palë uniforma verore dhe dy palë dimërore për 5 punëtoret, sipas specifikacionit ne dosje te tenderit
- Paga, më te gjitha kontributet për pozitën e menaxherit apo përgjegjësit nga kompania për mbikëqyrjen e punëtoreve cila pagë nuk mund te jete më e vogël se paga bazë Bruto e punëtorëve.
- Llogaritja e TVSH-së 18% në fund për të gjitha pozicionet si dhe,
- Totali i ofertës.

Çmimi jo normalisht i ulet i vlerësuar sipas analizës financiare e bene tenderin te papërgjegjshëm (Neni 61 i LPP).

PËRSHKRIMI I POZICIONEVE

Nr.	Përshkrimi	Numri I punëtoreve	Numri i orëve për një punëtorë	Numri i orëve gjatë një dite	Numri i orëve për një muaj
1.	Per sigurimin e objektit 12 orësh	2	12+12	24	360
2.	Për sigurimin e objektit 8 orësh	1	8	8	240
3.	Per sigurimin e objektit 12 orësh	2	12+12	24	360
			Totali i orëve		**960**

Duke pasur parsysh faktin qe AK është bazuar ne nenin 31 te LPP-se i cili përcakton Ekzekutimin e kontratave,

Ne vijim citoj paragrafi 2 i këtij neni;

t " *Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e performancës së kontratës në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo me rregullore në Kosovë ,me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike. Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh"*

Rregullorja nr001/2022 për Prokurimin Publik ne nenin 17.23 17.24,17.25 qe ndërlidhet me nenin 31 te LPP-se përcakton ;

Citoj nenin 17.23 -17.25 përcakton si ne vijim;

17.23 Në përputhje me nenin 31, paragrafi 1 i LPP-se, Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 të LPP-se dhe që janë paraqitur

në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontratë kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit.
17.24 Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e përformancës së kontratës të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike.
17.25 Autoriteti kontraktues mund të vendos, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh, si:

a. detyrim për të rekrutuar persona të papunë, dhe në veçanti persona të cilët nuk janë në punë për një periudhe të gjatë, ose

b. për të themeluar programe trajnimi për të papunët apo për të rinjtë gjatë zbatimit të kontratës; ose

c. detyrim për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave apo diversitetit etnik ose racor.

Sidoqoftë pavarësisht nga përgatitjet e analizave financiare nga ofertuesit kërkesat e zbatimit te Ligjit te punës dhe te Ligjit mbi Procedurat e Administratës Tatimore ne Kosovë dhe ne bazë të ligjeve tjera ne fuqi, janë obligime ligjore te mbikëqyrjes nga Inspektoratet përkatëse te ATK-së dhe Inspektoratit të Punës dhe duhet te zbatohen ne harmoni me ligjet në fuqi.
Bazuar ne aneksin 1 te dosjes se tenderit shohim se AK ka përshkruar ne mënyrë specifike obligimet e OE gjate ofrimit te kryerjes se shërbimeve te sigurimit fizik ne objektet e Institutit si dhe ka theksuar se OE i cili do te shpërblehet me kontratë është i obliguar qe te respektoj dispozitat e Ligjit te Punës dhe Ligjit për sigurimet private te sigurisë.
Pretendojmë **se nuk ka standard te analizës financiare** ne kërkesat e dosjen e tenderit qe është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Ne këtë rast AK –ja qe ka kërkuar si kriter analize financiarë mundet **te jete subjektive ne vlerësim** qe ka te drejt qe çdo anëtarë i komisionit te vlerësimit mundet te vendos sipas mendimit te vete.
Te drejtat e punëtoreve qe janë përcaktuar me Ligj te punës, këto te drejta janë specifikuar ne aneksin 1- te FDT-se qe ka të bëj me specifikim teknik dhe kërkohen te inkorporohen ne kontrata te punëtoreve.
Pas përfundimit te aktivitetit menaxheri i kontratës kur te nënshkruhet kontrata ndërmjet AK- dhe OE, pastaj AK ua kërkon kontratat krejt punëtoreve te OE me kushtet, specifikimet teknike qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit nëse nuk i ka atëherë kërkohet ti plotëson OE,.
Për vlerësim te kushteve te punës ne mes punëdhënësit dhe punëmarrësit si palë në marrëdhënien juridike të punës e qe hyjnë në Kontrate te punës i takon Ligjit te punës, a është respektuar Ligji i punës, këtu vendosin *exo ficio* apo me kërkesë (ankese) te punonjësve, Organet kompetente administrative te shtetit (Inspektorati I punës , Inspektorët e ATK-se) dhe ne fund Gjykata duke u bazuar ne kushtet e kontratës.
Pretendojmë se AK duke vendosur si kusht formale administrativ Analizën financiare ka vepruar ne kundërshtim me neni 17.23 17.24, 17.25 dhe 17.26 te Rregullores për Prokurimin Publik (Nr001/2022) pasi këto dispozita ju referohen kushteve te kontratës e ne këtë rast nuk është përgjegjësi e AK-se ti shqyrtoj.
Ne analize financiare nuk munden me u caktuar te gjitha kërkesat qe kërkohen

me Ligjin e prokurimit, me Ligjin e punës, me Ligjin e lehonisë me Ligjin mbi sigurimet e punëtorëve, me Ligjin e festave zyrtare, dhe me ligjet tjera te aplikueshme ne Kosove.

.

Marre parsysh faktin qe AK ne mënyrë te kundërligjshme ka caktuar Analizën financiare si kusht për kualifikim dhe përzgjedhje te OE, pretendojmë se OE" Scorpion" i cili ka nuk ka ofruar Analizën financiare konforme kërkesës se AK-se.
Nëse i qasemi Analizës financiare te dorëzuar me dosje te tenderit shohim se OE i propozuar për shpërblim te kontratës, do te shohim se i larte shënuari nuk ka ofruar çmime konforme kërkesave te Ligjit te punës dhe kërkesave tjera te përcaktuara ne aneksin1 te dosjes se tenderit.
Sa për ilustrim vetëm dy tri pozicione po i përshkruaj;
Te Pozicioni, Kalkulimi i uniformave shohim se OE ka ofruar çmimin total ne vlere prej 36 euro, qe sipas mendimit tone është çmim qe nuk është ne harmoni me numrin e punëtoreve.
OE ne fund te analizës financiare ka theksuar me sa vijon ne rubrikën Kalkulimi i uniformave ka theksuar me sa vijon;
Kompania e jone posedon sasi te konsiderueshme te uniformave dhe ky çmim i paraqitur është ne përputhje me nenin 40.16 te Rregullores Nr.001/2022.
Ky arsyetim i OE eshët ne kundërshtim me nenin 40.16 te rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik sepse neni 40.16 përcakton me sa vijon.
40.16 Në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.
a. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.
b. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.
Bazuar ne këtë fakt pretendoj se OE: Scorpion ka tentuar qe te i ve ne lajthitje juridike Autoritetin kontraktues duke cituar një dispozite e cila nuk korrespondon me arsyetimin e mos llogaritjes se çmimeve për dy pale uniforma për 5 punëtor.

Vlen te theksohet se AK ne Specifikimin teknik ka kërkuar Uniforma verore dhe uniforma dimërore për 5 punëtor.
Përveç këtij pozicioni OE i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij financiare ka ofruar çmime jo reale edhe ne këto pozicione;
Pozicioni 5 –pushimet vjetore dhe pozicioni 6, Pushimet mjekësore, kalkulimi i pagës për pushimet vjetore dhe mjekësore, për një muaj ka ofertuar me çmim prej 32.78 euro ne muaj, qe done te thotë se kalkulimi nuk është bere ne harmoni me kërkesën e AK-se sepse pushimet mjekësore nuk mund te parashihen sepse janë rrethana te pasigurta te cilat mund te ndodhin ose mos te ndodhin dhe çdo kalkulim financiar pre kompensim te pushim mjekësor është fiktiv.
Këto te drejta janë te përcaktuara me Ligj te punës dhe me kontrate te punës.

Duke u bazuar ne dëshminë dokumentare te OE "Scorpion, pretendoj se analiza e tij financiare nuk është ne pajtim me kërkesën e AK.

AK është dashur qe ta eliminoj nga gara e mëtejme këtë OE.
Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara pretendojmë se AK gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se.

- **Neni 60 Kriteret për dhënie kontratës**

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili ne është rekomanduar për shpërblim te kontratës dhe ka ofruar çmimin me te larte ne vlere prej 90,316.80 euro ne krahasim me çmimin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim i cili ka ofruar çmimin me te ulte ne vlere prej 86,169.60 €, dhe është eliminuar, ka bere shkelje te dispozitës se nenit 60 te LPP-se , duke mos respektuar Kriterin për dhënie të kontratës i cili ka qen i përcaktuar ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit; Çmimin më të ultë, i tenderit te përgjegjshëm.
Citoj dispozitën e nenit 60 te LPP-se;

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 te LPP-se pretendojmë se AK ka bere shkelje te dispozitave te këtij neni me rastin e marrjes se Vendimit për dhënie te kontratës për OE i cili për nga çmimi është më të lartë, pra AK nuk ka respektuar Kriterin për dhënie te kontratës.

- **Nenit 61 , Tenderët Jo-Normalisht te ultë**

Pretendojmë se AK fillimisht përmes rekomandimit të Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit dhe me vone përmes aprovimit te ZPP-se , ka bërë shkelje te dispozitave të nenit 61, paragrafi 3, të LPP-së dhe me ketë rast gabimisht ka vlerësuar se çmimi i dhënë ne tender është çmim i cili nuk është ne pajtim me kërkesën e AK-se dhe si rrjedhojë e kësaj ka vlerësuar tenderin në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

LPP ne RK ne nenin 61 në mënyre detale parasheh kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të kualifikohet një tender si tender me çmim Jo –Normalisht të ultë.

LPP dhe Rregullorja për Prokurimin publik obligon AK qe nëse OE ofron oferte me çmime jo normalisht te ultë edhe vetëm për një pozicion te cilin ka ofertuar.

Nëse i qasemi Ofertës financiare te Grupit te OE te rekomanduar për kontratë do te shohim se te Pozicioni, Kalkulimi i uniformave shohim se OE ka ofruar çmimin total ne vlere prej 36 euro, qe sipas mendimit tone është çmim normalisht i ulte dhe nuk është ne harmoni me numrin e punëtoreve.

Vlen te theksohet se AK ne Specifikimin teknik ka kërkuar Uniforma verore dhe uniforma dimërore për 5 punëtor.

Përveç këtij pozicioni OE i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij financiare ka ofruar çmime te ultë edhe ne këto pozicione 5 –pushimet vjetore dhe pozicioni 6 kalkulimi i pagës për pushimet vjetore për një muaj ka ofertuar me çmim prej 32.78 euro ne muaj, qe done te thotë se kalkulimi nuk është bere ne harmoni me kërkesën e AK-se sepse punëtoreve përveç pushimit vjetor i takon e drejta edhe ne kompensim te mungesës nga pune ne harmoni me Ligj te punës (martesës, lindjes se femiut, vdekjes se anëtarit te ngushtë te familjes etj)

OE i propozuar për kontratë ka kalkuluar pagën mujore edhe për Menaxher te kontratës nga ana e OE, ndërkaq ne FDT nuk është kërkuar paga e tij.

AK është dashur ta eliminoj nga aktiviteti i prokurimit OE :Scorpion për arsye se nuk ka kalkuluar çmimet ne baze te kërkesave te AK-se.

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar në vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit , duke vlerësuar gabimisht ofertën e Grupit te OE te eliminuar "MEB LLC "&K.F.S "Major" SH.A si ofertë me çmim Jo-Normalisht të ultë edhe përkundër ofrimit te **Deklaratës se nënshkruar dhe vulosur se** Grupi i OE ne rast se shpërblehet me kontratë, do te i përmbush te gjitha kërkesat e AK-se, sa i përket pagesës se pagave dhe tatimeve te aplikueshme ne Kosove, të dhëna mbi arsyesh mërinë e çmimit të dhëne në ofertën financiare si dhe do te respektoj dispozitat e Ligjit te punës.

Pretendojmë se oferta financiare, ka qen ofertë reale dhe e bazuar në çmimet reale në tregun e punës se Kosovës.

II/ Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.

Neni 38, Sqarimi i tenderëve,

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 38.3 te Rregullores për Prokurimin Publik.

Neni 38.3 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik ne mënyrë te qarte përcakton rastet se kur Autoriteti kontraktues duhet të kërkoj ndonjë informacion apo dokumente te cilat i mungojnë OE ne dosjen e tij te tenderit.

Duke u bazuar ne nenin 38.3 te Rregullores i cili shprehimisht përcakton se këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate, i cili ne rastin konkret Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-se që ndërlidhet me nenin 38 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Citoj dispozitën e nenit 38.3 te Rregullores.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme

që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.
Ne letrën standarde te tenderuesit te eliminuar AK ka konstatuar se dosjes se Grupit te OE ne këtë rast te parashtruesit te kërkesës i ka munguar dëshmia dokumentare konforme Kërkesës 4,
Të dëshmohet me Raport të vlerësimit të riskut nga një institucion apo kompani private e licencuar për Vlerësimin e Riskut ne Kosove.
AK është dashur te veproj ne pajtim me nenin38 te Rregullores për prokurimin Publik qe ndërlidhet 72 te LPP-se duke i kërkuar sqarim te tenderit.
Ne po ua bashkëngjisim raportin e vlerësimit të riskut nga një kompani private e licencuar për Vlerësimin e Riskut ne vendet e punës.

Neni , 41, Tenderët jo-normalisht të ultë

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar në zbatimin e nenit 41 të e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022 qe ndërlidhet me nenin 61 te LPP-se.
Nëse i referohemi nenit 41.1 të kësaj Rregulloreje shohim se si duhet te veprohet, kur AK konsideron se një oferte e dorëzuar duhet te trajtohet si oferte e pa realizueshme gjate implementimit te kontratës dhe me çmim qe sipas LPP-se dhe Rregullores se Prokurimit publik trajtohet Çmim-normalisht i ulte.
Ne nenin 41 te kësaj Rregulloreje koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.
Baza ne paragrafin 41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë ***inter partes*** me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.
Bazuar ne platformën e -prokurimit nuk kemi vërejtur se AK, i është drejtuar OE me Letrën standarde për tenderues jo-normalisht te ulte siç e përcakton LPP dhe legjislacioni dytësor si dhe obligimin tjetër ligjor qe te njoftohet KRPP-ja.
Ne këtë situate AK është i obliguar qe; të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, si dhe ta i përmbahet kushteve te përcaktuara si ne vijim;

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Në baze te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se (B58) shohim se në ketë tender kanë marrë pjese 4 tenderues.

1. Grupi i OE: MEB LLC& KSF"MAJOR" SH.A i cili ka ofertuar me çmimin total ne vlere prej 86,169.60 euro
2. "Kompania e Sigurimit Fizik, "Scorpion", i cili ka ofertuar me çmimin total ne vlere prej 90,316.80 euro ,
3. "Kompania e Sigurimit Fizik "SAS"sh.p.k i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 86,169.60 euro.
4. "Kompania e Sigurimit Fizik " Besa Security" i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 79,948.80 euro

Ne baze te letrave standarde shohim se 3 OE janë eliminuar ne baze te një pragu i cili është dashur te jete Vlera e parashikuar e kontratës e cila është e caktuar nga ana e AK-se 96,000.00 euro ,sepse AK gjate përcaktimit te vlerës se parashikuar ka kalkuluar te gjitha nen kriteret te ciklat duhet te plotësohen ne ofertën financiare.

Autoriteti kontraktues është dashur te veproj ne pajtim me nenin 41.4 te Rregullores i cili përcakton me sa vijon;
41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së

Pretendojmë se AK nuk ka baze ligjore për te trajtuar ofertën me çmim jo normalisht te ulte konforme nenit 41.3 te Rregullores qe ndërlidhet me nenin 61 te LPP-se.
Duke pasur parasysh këto fakte i propozoj Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit qe pas aplikimit te dispozitave te LPP-se qe kane te bëjnë me nenin 59 dhe nenin 61 te LPP-se te marre këtë;

Duke pasur parasysh këto fakte i propozoj Panelit të OSHP-se qe te pas administrimit te provave dhe fakteve qe të marrë këtë;

VENDIM

- **TE APROVOJ,** Ankesën si të bazuar të parashtruar nga Grupi OE; MEB LLC&K.S.F" MAJOR" ,
- **TE ANULOJ** , Njoftimin mbi Vendimin e AK-se te datës 14 .06. 2024 mbi rezultatin e tenderit (B58) ku është propozuar për shpërblim te kontratës OE: "Scorpion" i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit më të larte ne krahasim me parashtruesit e kërkesës
  TE KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM, dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes te cilat janë te përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit ne pajtim me LPP-ne, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik te vitit 2023.

Mbetemi me shpresë se ankesa e jone do të shqyrtohet, pozitivisht.
Me nderime,
Lideri i Grupit te OE MEB LLC &KSF"MAJOR"
Silaaytolun Damka

SECURITY GUARD SECURITY MEB No:810975576 Ferizaj Kosova

7. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri më tani dëme materiale ne vlere prej 250 euro për përgatitjen e Kërkesës për rishqyrtim

8. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin mbi vendimin e AK-se " (B58)
c) një kopje të "Procesverbalit të hapjes publike të tenderëve"
d) një kopje te Raportit për vlerësimin e riskut në vendet e punës,
e) një kopje të Kërkesës për rishqyrtim,
f) një kopje te Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të AK-se te datës 20.06.2024.